



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04 - 0048128-2/24 dt. 29.07.2024
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 6 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, si dhe Propozim – Vendimin Nr. 01-020/04-0048128/24, dt. 17.07.2024, të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit për Transportin Rrugor Lokal në Komunën e Mitrovicës së Jugut)


1. **Formohet** Komisioni për Hartimin e Planit për Transportin Rrugor Lokal në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Gjylferije Ademi - Kadri – kryetare, (DSHPI);
 - 1.2. Rexhep Hajdari – anëtar, (DSHPI);
 - 1.3. Ardian Brahimi – anëtar, (DPU);
 - 1.4. Nexhmi Hasani – anëtar, (DPU);
 - 1.5. Bedri Ferati – anëtar, (DI);
 - 1.6. Skender Sadiku – anëtar, (Ekspert i komunikacionit);
 - 1.7. Fatime Beqiri – anëtare, (DGJKP);
 - 1.8. Naser Shala – anëtar, (DBF).
 - 1.9. Hajrush Salihu – anëtar, (DI);
2. Komisioni i lartcekur obligohet të bëjë Hartimin e Draft – Planit për Transportin Rrugor Lokal në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft – Planit të lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe

Publikimin e Akteve të Komunës, Ligjin Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, Planin e Mobilitetit 2020-2028, Planin Zhvillimor Komunal, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Mandati i Komisionit të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas 6 (gjashtë) muaj nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës


Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim – Vendimi Nr. 01-020/04-0048128/24, dt. 17.07.2024

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

